



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

**VENDIM
Nr. 62, datë 27.07.2009**

**PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT
ATLANTIK SH.A**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 23 të Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Pas inspektimit të kryer pranë shoqërisë “Atlantik” sh.a dhe analizës së gjendjes financiare të vitit 2008 dhe 3 muhorit të parë të vitit 2009, rezultoi se shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozita të caktuara të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”. Shoqëria është vënë në dijeni të shkeljeve të konstatuara si nga raporti përfundimtar i inspektimit (pas pasqyrimit dhe të observacioneve të shoqërisë) ashtu edhe nëpërmjet takimeve zyrtare të kryera nga Autoriteti me përfaqësues të shoqërisë. Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Të sanksionojë shoqërinë e sigurimit “Atlantik” sh.a, me gjobë në masën 1,500,000 lekë, bazuar në nenin 165, pika 1, gërma g), të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, për shkelje dispozitave të nenit 115, pasi nuk ka paraqitur në Autoritet një llogaridhënie të detajuar të veprimtarisë të shoqërisë në përputhje me formën, listën dhe afatet e përcaktuara në udhëzimet e Autoritetit.
2. Të urdhërojë shoqërinë, bazuar në nenin 124, pika 1, gërma ë) dhe nenin 125, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, të marrë masa për eliminimin e shkeljeve të nenit 103, të Ligjit nr.

9267, datë 29.07.2004, dhe të paraqesë në Autoritet brenda datës 30.09.2009, një raport të detajuar për masat e marra për eliminimin e këtyre shkeljeve.

3. Të urdhërojë shoqërinë “Atlantik” sh.a, bazuar në nenin 126, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, të përmbush detyrimin për raportim të saktë dhe në kohë në Autoritet.
4. Të urdhërojë që, brenda datës 30.09.2009, shoqëria të depozitojë në Autoritet, Raportin e Kontrollit të Brendshëm në përputhje me kërkesat e neneve 69 dhe 70, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.
5. Të urdhërojë shoqërinë “Atlantik” sh.a, të plotësojë Këshillin Mbikëqyrës sipas kërkesave të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.
6. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI